



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.451/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Marijana Simijonovic, nga komuna e Novo Bërdës, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.10.2017 mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Marijana Simijonovic, nga komuna e Novo Bërdës, me numër ZL.Anr.451/2017 e datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i më datën 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Marijana Simijonovic, nga komuna e Novo Bërdës, me të cilën pretendon se në vendvotimin nr.1412/02D ka pasur parregullësi gjatë numërimit të votave për kandidatët e subjektit politik Srpska Lista. Parashtruesja e ankesës pretendon se kutia e votimit së bashku me material është dorëzuar në KKZ duke qenë i hapur dhe procesverbali me rezultatet e votimit nuk është paraqitur në vendvotim 1412/02 pas përfundimit të numërimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimin 1412/02D, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatit të votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankueses Marijana Simijonovic, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.451/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdj Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.